ADEM ZAPLLUZHA

KUR DEHEN PERËNDITË

Redaktor:
Xhevahir Cirongu

Recensent
Mazllum Baraliu

Lektor:
Xhevahir Cirongu

ADEM ZAPLLUZHA

KUR DEHEN PERËNDITË

Shoqata e Shkrimtarëve
“Fahri Fazliu”
Kastriot, 2014

Ky njeri prej stralli

Cikli i parë

Parathënie

Poezi me ngjyra ylberi shpirtëror

Të lexosh poezitë e poetit Kosovar ***Adem Zaplluzha***, s'ke se si të mos ndjesh që në fillim aromën e plisit të tokës së vendlindjes . Ajo shpaloset me gjithë fuqinë e saj magjike, dhe të rrok pas vetes si një lum që ka ujë të kulluar për gjatë rrugëtimit të leximit. Në këtë rrugëtim , kur ke lexuar 86 vëllimet e këtij poeti, të cilat janë tashmë në duart e dashamirëve të librit, e sidomos adhuruesit e poezisë,ndjen një krenari të ligjshme , sepse vargu të ngroh si dielli. Në këtë vëllim të ri, që poeti Adem Zaplluzha e ka ndarë në tre pjesë, me titull ***''Kur dehen perënditë''***, vargu poetik përshkruhet nga fillimi gjer në fund me ndjenjën e thellë të dashurisë njerëzore. Poezitë e autorit Adem Zaplluzha, janë me rrënjë te plisi i tokës sonë Shqipëri. Atdheu , natyra e njeriu, janë të shkrira në një plan të vetëm në këtë vëllim poetik. Ato flasin me gjuhën filozofike të thjesht e japin mesazhe të qarta për te lexuesi, sepse poezia që në lashtësi e deri sot, ka qenë pjesë e shprehjes shpirtëror të njerëzimit.

Poezia ka qenë dhe është oazë që ka mbushur shpirtin e njerëzve, si në gëzime e në hidhërime, për të lartësuar ndjenjat njerëzore duke u dhënë forcën e

gurit dhe ëmbëlsinë e mjalti të fjalës. Të tilla janë edhe poezitë e poetit **Adem Zaplluzha**, sa të thjeshta, aq edhe kuptimplota me ‘’farën e grurit’’shpirtëror që kanë në vetvete ato, e përcjellin fuqishëm për te lexuesi ynë. Laramania e poezive që sjell poeti në këtë vëllim të ri me titullin ***’’Kur dehen perënditë’’***, është një shprehje e gjallë e jetë dhënëse, sepse vargu poetik ka rrënjët e tija me degët e frutat krijuese të dhuruar nga vetë perëndia, që më së fundi për poetin vargu është një fryt ‘’Shege’’ me rruaza të kuqe gjaku në dehje që s’ka vdekje kurrë. Në poezinë me titull **‘’Ku njeri prej stralli’’** tregon lindjen e njeriut nga pluhuri kozmik e që ka forcën si guri i zjarrtë të strallit e lëshon zjarr e xixa fjale e tinguj me ngjyra ylberi në gjithësinë , ku vetë njeriu e poeti është pjesë e këtij realiteti jetësor. Ndërthurja e faktorit historik dhe me mite historike njerëzore, si dhe të heronjve, janë përshkruar me ndjenjë e patos poetik në poezitë e shkruara të autorit Adem Zaplluzha. Ato kanë vargun e qiellit kaltërosh e të detit të kaltër të mendimeve. Në poezinë **‘’Po të ishte ndryshe’’** (Prolog) ai thotë se: *‘’**Sytë tuaja të kaltër/ i përngjanin lotit të Adriatikut..’’***. Kurse në poezinë me titull ***‘’Ky njeri prej stralli’’*** na jep dritën e flakës që del nga gur i strallit të vargut poetik e qenien njerëzore, që s’shuhet kurrë sepse shpirti nuk

vdes , por diku ai jeton në qiellin e kaltër atje te Zoti!

..Dhe poeti na e sjell shprehimisht kështu:

''I shkulte lisat e sinonimeve,
për të mbjellë dashurinë
në kraharorin e atdheut të dërmuar.''

Vështrimi poetik letrar të poezive të këtij autori ngjasojnë si fibra optike në gjithë brendinë e tyre. Aty gjen dashurinë njerëzore e të qenit njeri, hipokrizinë, historitë, tokën e lumin, pemët me gjethet,gurin dhe zogjtë, hënën me yjet, hapësirën qiellore e kozmosin, heroin e njeriun e thjeshtë, të gjitha këto të përfshira në korpusin e vargut poetik. Te nëna natyrë poeti nuk ndahet për asnjë çast, dhe nga shpirti i tij del llava poetike e vargu me ngjyra ylberi . Ato janë spërkatur me vesën e avujt e frymës njerëzore, të shkrira në një të vetme që quhet ***''Dashuri njerëzore!''.*** Dhe kjo duket qartë në lejueshmërinë e vargjeve në gjithësinë e poezive e më konkretisht te poezia që ia kushton poetit lirik Frederik Reshpes.

Te poezia me titull: **''Më duket se atë natë''**, **ai shkruan këto vargje: ''Mbi parmakët e qelqta të mendimeve/ binte nga pak shi''**.(për natyrën e mendimin).

..Ose te poezia që ia kushton poetit Frederik Reshpes, midis vargjeve të tjera thotë me dhimbje e kujtim malli për njeriun e letrave shqipe, e sidomos

për poetin, për dhimbjen e vargut të këtij poeti. Vargu del si gurrë nga thellësia e shpirtit të poetit për poetin. Ja si thotë Adem Zaplluzha:

‘’Jo ,or miku im i mirë
Nuk vdiq Frederiku!’’

Por , edhe për mjegullat që ngrihen e lartësohen lartë në qiell, së bashku me mendimet e poetit pikojnë si vesa e mëngjesit në shpirtin e tij e derdhen në lumin e vargut poetik. Pra, te vëllimi më i ri të titulluar : ***‘’Kur dehen perënditë’’***,lexuesi gjen xhevahire shpirtërore aty

‘’Mjegullat me do riga të vetmuara
Vajtojnë fatin e reve’’.

Apo te poezia me titull ***‘’ Të mos qajë edhe ai copë druri’’*** i cili na jep kështu këto vargje:

…….

’’Të mos qajë edhe ai copë druri
Të mos dënes si guri i lagjes,
Ku kanë pritur pleqtë e fshatit
Kthimin e djemve nga kurbeti’’.

Edhe shprehjet metaforike i përdor disi të kursyera, me gjetje gjithmonë në ngjitje për nga domethënia e tyre kur derdh në vargun poetik. Brenda kullës së shpirtit, furtunat e jetës janë në shpërthim e sipër te autori. Ai këtë e tregon me vargun që shkruan çdo ditë, mbi fletën e bardhë, që mendimi i cili buron

nga kulla e shpirtit të tij të përjetësohet në varg poetik, si një mënyrë rebelimi ndaj fenomeneve që ka kaluar gjatë jetës, por edhe faktorit jetik ku jetojmë në jetën tonë të përditshme si atë shoqërore e socialekonomike. Kuptimplotë ky fakt shprehet te poezia ***''Nga syri i një peme të egër''*** , më konkretisht

''I kujt ishte ai sarkofag
Nga i cili fluturuan
Disa zogj të çmendur!?

Por, autori i librit jep me detaje edhe tragjiken e jetës, vdekjen, truallin e gurin e përmotshëm që s'ka ''vdekje'', pra , varret me epitafet e tyre që flasin me heshtjen te të gjallët. Dhe ai e përshkruan qartazi me këto vargje :

''Më lër të pi trishtimin e këtij helmi,
…doli edhe nata''….

Të gjitha metaforat që përdor autori Adem Zaplluzha në poezitë e këtij vëllimi, janë shprehje e pjekurisë së vargut që i jep jetë e domethënie gjithçka që e rrethon njeriun në këtë botë me plotë mistere. Në fund të fundit , jeta duhet jetuar ashtu si është, por mesazhet e autorit na tregojnë se duhet edhe guxim e qëndresë ndaj fenomeneve e pengesave gjatë rrugëtimit të jetës sonë. Të mos thyhemi para vështirësive, dhe kur njeriu ka shpirtin e madh, lartësohet deri në pavdekësi. Rrënjët e shpirtit metaforik të shprehura në poezitë e autorit,

na jepen me detaje të arrirë nëpërmjet artit e fjalës së shkruar.

Edhe ky vëllim i ri poetik ***‘’ Kur dehen perënditë’’*** është një gur themeli që i vendoset ‘’ kështjellës’’ krijuese poetike të autorit kosovar Adem Zaplluzha.

Xhevahir Cirongu
Publicist, poet, shkrimtar
Durrës, 24 tetor 2013.

NGA FISI IM BYTYQ

Më duket se kur gjeneza e njeriut
Ishte në udhëkryq
Në këto shpirtra malesh!
Si nëpër balada
Mbiu nga dheu amë
Një fis i pavdekshëm
Fisi im bytyq.

Aq shumë i donte dyndjet
Saqë foletë e ekzistencës
I ndërtoi nëpër botë,
Ky fis sa trim
Po aq edhe bujar.
Ka se për çfarë të mburret
Ndër shekuj
Me të kaluarën edhe sot.

Shikoni këto male
Atje pas shpinës së atyre kreshtave,
Dhe nëpër udhët e kujtesës...
Kudo do të rastisni
Të ngulur në shpirtin e tokës.
Nga një kryq
Lënë një lloj pengu,
Në shpirtin e këtyre trojeve
Nga fisi im bytyq.

PO TË ISHTE NDRYSHE

Prolog

Kur kohërat e zeza
Depërtuan nëpër grykat e maleve
Nga gjiri i Ilirisë,
Dolën sheshit
Burrat ngjeshur me patërshana.

Si një sëmundje e keqe
Legjionet e tmerrit,
U vërtitën fushave
Dogjën anijet,
Por një anije legjendare
U bëri ballë vdekjeve!

Diku në parzmën e maleve
Tok me pishat e bardha,
Ndizeshin zjarret e lirisë
Çoheshin peshë
Dallgët e shthurura të Adriatikut.

Atdheu në rrezik
Nën bedenat e kështjellave
Nga një kllapi e madhe,
Si kuçedrat zgjoheshin burrat
Në të katër anët e vendit
Jehuan daullet e kushtrimit.

Për ta mbrojtur nderin e Arbrit
Nga legjionet e zeza,
Dolën djemuria në bejleg
Ku trimat e çartur
Ia kalonin
Me dhjetëra herë trimave.

1.

Prijësi im
Ju nuk e deshët famën,
As pekulet
Nuk ju thirri kryqi i shkulur,
Por u kthyet , o Gjergj i madh
Pas zërit të atdheut.

Sytë tuaja të kaltër
I përngjanin lotit të Adriatikut,
Erdhët
Mbi një kalë prej vetëtime!
Në majat e Krujës krenare
Mbollët pas një kohe të gjatë,
Shumë të gjatë
Mbollët ullirin e lirisë.

2.

Pas Jush u ngritën ortekët
Prej njerëzve,
Lirinë si ormi ia sollët atdheut.

Disa thonë se ishit atleti
I krishterimit,
Sykaltri im
Unë pohoj të kundërtën.

Erdhët mbi një kalë të bardhë
Si dëbora e Krujës,
Dhe populli Ju pagëzoi
Atleti i lirisë.

3

Akoma edhe sot
Kudo nëpër Dardani përsëriten
Fjalët e tuaja:
“Lirinë nuk ua solla unë
Por e gjeta në shpirtin e juaj”

Kryetrimi im
Sa shumë i përngjani Krishtit,
Kryqi i Juaj ishte shpata
Dhe shpirti i popullit.

Kalëruat nëpër shtigjet e viteve
Kalëruat si perëndi
Mbi një kalë prej vetëtime.

Si zëri i një perëndie ilire
Dëgjohej piskama e maleve
Sykaltri im.
Si zëri i juaj prej zjarri
Dëgjohej ajo thirrje e lashtë
Ilire
E atdheut të shkelur.

4.

Sa herë që burrat i grithnin fytyrat
Ju ishit pranë tyre,
Dhe si engjëlli i mirë
Me gjuhë prej shpate
I shëronit dhembjet.
Jo vetëm të njerëzve
Por edhe kuajve
Dhe të gurëve.

Vetullat si patërshanat ilire
I mbulonin plagët e lisave,
Kur qanin nënat
Nga trishtimi
Hingëllonin edhe kuajt e luftës.
E luftërat
Nuk kishin të ndalur
Në zemrën e shkrumbuar të Ilirisë.

5.

Prej një lufte në tjetrën
Shndritnin shpatat mprehta,
Nuk pushonin së kënduari
As xhubletat.

Daullet e kushtrimit
Zgjoheshin para agimeve të pagjumë,
Aq shumë e donin lirinë njerëzit
Sa që asnjëherë nuk fjetën.

Kurse Ju Imzot
Zgjoheshit mbi kalin e erërave!
Zgjoheshit i përgjumur
Dhe si dragonjtë e përrallave
I shtrëngonit dizgjinët.

Shpeshherë e dëgjoja plakun tim
Kur thoshte:
Biro !
Gjergji kurrë nuk ka fjetur!?

Po të ishte ndryshe
Nuk di!...
Se në cilin Ferr
Do të zgjoheshim
O Gjergj beu i madh.

EPILOG

Një popull që fle
E pret një rrugë e ngratë
Thoshte im atë.

O lum miku
Uji fle,
Por jo edhe armiku!

Ti, o i lumi hapi sytë
Nëse do
Në lotin tënd mos me u mbytë.

Thonë se,
kështu fliste një urtarë
Kur thyhej ndonjë degë e tharë.

Prishtinë, 01 shtator 2013

KY NJERI PREJ STRALLI

Me një kërrabë të lakuar
Kalon nëpër zjarrminë e tokës,
Ecën njeriu me shall në kokë
Kokëlartë
Si shkëmbinjtë e këtyre maleve.

Edhe kur e ngacmojnë
Ky njeri prej stralli,
Asnjëherë nuk e zgjatë qafën
Aq shumë e do vertikalen
Sa që i përngjan rrapeve të Sharrit.

Ngrica e as acari i trentë
S'patën se çfarë t'i bëjnë,
Për një fjalë goje.
I shkulte malet me rrënjë
I shkulte lisat e sinonimeve,
Për t'i mbjellë dashurinë
Në kraharorin e atdheut të dërmuar.

HERË FUNDOSEM

Ditët nuk janë më të njëjta
Kjo e sotmja,
Sa shumë ndryshon nga dita e djeshme.
Sa që më duket se ëndrrat e mija
Nuk më përkasin vetëm mua..!

Herë fundosem
Në fundin e ndonjë filxhani,
Të pa larë si duhet
E herë verës së vjetër,
Ja prishi gjumin
Që fle në shpirtin e pagurit.

Dikur vonë
Kur mbetem pa asnjë përrallë,
Dal në rudinë
Dhe bisedoj me delet rude
Ka kohë që më kanë harruar njerëzit.

Kur më ikin edhe fluturat e fundit
I kyçi llambat e yjeve,
Dhe bisedoj
Një kohë të gjatë bisedoj
Me mjegullat.

Nëse e takoj gazetashitësin
Në kafenenë tonë të preferuar,
Edhe në këtë skamje
Të paskajshme.
Rrufisim nga një kafe farmak
Pa menduar për çmim.

POQË SE TË PREMTON KOHA

Nuk ka gjë më të bukur
Se sa të ecësh
Pa kurrfarë brenge...
Të kalosh nëpër mendimet e tua
kryelartë si një patriark.

Nëse të pengojnë mjegullat
Ti sërish duhet të ecësh,
Sepse vetë e ke zgjedh rrugën
Nga e cila
Nuk mund të dalësh askurrë.

Një ditë,
Nëse rastësisht harron
Prejardhjen tënde,
Mos hezito hapi librat e vjetër
Ku mund ta gjesh fillin e merimangës.

Poqe, se të premton koha
Bisedo me arkeologët,
Ose me ndonjë kustos të dehur
Sepse njëri prej këtyre,
Me siguri
Do të të tregoj për prejardhjen tënde.

I PËRNGJAJNË PANTOMIMËS

Një poet thotë se dashuria vjen
Kurse tjetri me kokëfortësi,
Pohon se ajo ikën
Kurse unë them të kundërtën,
As nuk vjen
E as nuk ka se ku të ikën.

Dashuria i përngjan luleborës
Ajo lind në kristalet e shpirtit,
Dhe asnjë forcë
Kurrsesi nuk mundet,
Dhe s'ka fuqi
Ta shuaj zjarrin e saj.

Njerëzit e dashuruar
Janë të papeshë,
I përngjajnë pantomimës.
Ose lindin nga vetë qenia e zërit
Dhe aq bukur duken,
Sa që mund të krahasohen
Me vetë ekzistencën.

MË DUKET SE ATË NATË

Më duket se atë natë
Shumë pak folëm,
Ndoshta!...
As që kishim
Se çka me i thënë njëri tjetrit.

Ishte një kohë e brishtë
Era lozte si e çmendur.
Një lojë arkaike
Atë lojë,
Të pamëshirshme të gjetheve.

Mbi parmakët e qelqta të mendimeve
Binte nga pak shi.
E nga pak
Një përzierje e pa definuar.

Ose të reshurat
I kishin humbur të gjitha udhët,
Dhe largoheshin
Në një drejtim të panjohur.

Duart tona u përzien me shakullinën,
Dhe humbën
Nëpër zgafellet e përqafimeve.
Më duket se atë natë
Na humbën të gjitha fjalët...!

SA HERË QË PIKËLLOHET

Ky miku im poet
Me gjasa është i çmendur,
Sa herë që flasim
Ose rastisim në ndonjë femër të bukur,
Me kokëfortësi krahason
Më këmbët e Shën Mërisë.

Duket si budalla,
Por me gjasa ka shumë të drejtë
Ky poet i marrë.
Aq shumë i do femrat,
Sa që në secilin xhep
Mbanë nga një pasqyre konvekse.

Fërshëllima e tij
I përngjan atij të bilbilit,
Sa herë pikëllohet
E vendos shpirtin e tij në penel.
Dhe me një afsh të paparë
Qanë me lot të trishtë,
Si ndonjë pulëbardhë e plagosur.

SËRISH NJË ERË E DALLDISUR

Një erë e fortë çan lisin në dysh
Me ngulshim,
Degët si në ndonjë përrallë
Lëshohen të thyera kah toka.

Këputen rrënjët,
Kopshtin e ka zënë një nostalgji
Në shpirtin e gjetheve,
Asnjë mollë nuk paska mbetur.

Sërish një erë e dalldisur
Si një trishtim i madh,
Mbinë në lotin e pulëbardhave
Kur në ëndrrat e grave,
Përkunden anijet e peshkatarëve.

POETI RRESHPJA

Jo or miku im i mirë
Nuk vdiq Frederiku!
Yjet vetëm shuhen
Kalojnë prej një gjendje të ngurtë.
Në një tjetër gjendje të papeshë
Dhe s'vdesin asnjëherë.

Vetëm i ndërrojnë vendet
Prej një qielli,
Udhëtojnë pa u ndalur
Udhëtojnë si mendjet e njerëzve
Në një qiell tjetër.

Shiko atë yll atje të vetmuar
Mes atyre yjeve endacak,
M'u në ato ëndrra
Te një karafil që s'venitet.
Poeti Rreshpja
Mbolli një shpirt të madh
Për t'u dhënë dritë
Yjeve të vegjël
Që rriten shkurreve.

KALORËSIT E KUQ TË GJAKUT

Pak më parë
Vrapuan nëpër damarët e fishkura,
Të drurit të ahut
Kalorësit e kuq të gjakut.
Vrapuan drejtë një historie
Për t'ua zënë shtigjet arkeologëve.

Dolën në mes të arenës
Disa lloje bishash të zeza,
Hungëruan si tërbimet e luanëve
Rrëqethen lagështit e mureve.
Nga sytë e sëmurë të legjionarëve
Kanë nisur të mbinë kërpudha të kalbura.

Kurse kalaja e Prizrenit
Krenohet me pleqërinë e gurëve
Krenohet,
Dhe i injoron arkeologët e përgjumur
Të cilit nuk janë në gjendje
Të depërtojnë në sekretin e mjegullave
Që flenë nën themelet e vetë kalasë.

SHKUNDJET E GJETHEVE

Për pak të dal nga kjo ëndërr
Syri im i majtë,
Nuk shihte aq qartë
Notonte e notonte në verbësinë
E një përralle të lashtë.

Kurse dora e djathtë
Nuk ishte në gjendje t'i prekte,
Shkundjet e gjetheve.
Që binin në tokë,
Si thinjat e ngrira të flokëve të hënës.

Ky gur i etur
Sa shumë po i përngjan,
Devesë me dy gunga
E cila ka kohë që ka harruar.
Se si duket shkretëtira
Në sytë e kaltër të një hardhuce
Mbinë si trishtimet
cicërimat e zogjve endacak.

Për pak të hyj në një ëndërr tjetër
Ku asnjëherë nuk kanë pushuar shirat,
Zambakët sot për habi të njerëzve
Çelën në disa lloje ngjyrash
Në penelin e ylberit të përsosur.

KUR MË NUK DO TË JEM

Kur më nuk do të jem
Në zërin tuaj të frikësuar,
Ju do të dëgjoni
Hingëllimat e arkivoleve,
S'do të pushojnë
As lehjet e qenve në ullukët e çative.

Netët do jenë më të shkurta
Kurse dimrat,
Nuk do të dinë të përfundojnë.
Do vijnë pa ftesë
Dhe sërish,
Do ikin shakullinat tej maleve...!

Do dynden këndej pari
Edhe do njerëz të tjerë,
Nga disa planete
Të pazbuluara,
Dhe do jenë pak më ndryshe se ju.

Ata nuk do të kenë lidhje
Me vdekjen time,
Por me mbjelljen e pemëve tropikale
Dhe tharjen e lumenjve
Për agrume të reja.

Kur më nuk do të jem
S'do të ndodh asgjë e rëndësishme,
Vetëm nëpër rrugët e qytetit
Përpos që dritat e kuqe,
Herë do të kyçen
E herë do të shkyçen
Në ëndrrat e thinjura të netëve.

Prishtinë, 02 shtator 2013

VARREVE UA KTHEJMË SHPINËN

Ne ikim hapësirave
Për çdo ditë ikim...
Largohemi prej vetvetes
Sa që një ditë,
Nën lëkurën tonë bëhemi të huaj.

S'i njohim as këpucët e fëmijërisë
Që me varfërinë e tyre,
I patën blerë prindërit tanë
Nëpër tavolinat e kumarit
I humbim të gjitha ndjenjat njerëzore.

Si të huaj shikojmë se si vajtojnë kryqet
Varreve ua kthejmë shpinë,
Dhe asnjëherë s'mendojmë
Se një ditë ne deshëm ose jo,
Do vijë deri te ne një kryq prej loti.

Nuk di mbase ikjet i përkasin
Vetëm njerëzve,
Minjtë asnjëherë s'largohen më larg.
Se sa që mund ta nuhasin
Vërrimën e tyre me dy hyrje,
Kurse për ikjet u kanë lënë
Vetëm njerëzve të mendojnë.

PJATAT E DRUNJTA

Ishte koha e darkës,
Te lagja e krishterëve dëgjohej
Zëri vajtues i një kambane.
Shtatë persona pranë tavolinës
Ishin ulur të han,
Ose donin ta shuanin epshin e urisë.

Prej të shtatëve që i përtypnin
Gjethet e një vjeshte të vonuar,
Gjashtë veta mungonin
Mungonin edhe mushkonjat
E verdha.

Në mes të dhomës
Mbi një tavolinë të vjetër,
Flinin pjatat e drunjta
Po ashtu edhe lugët e palara.
Sajonin në hapësirë
Një pikturë surrealiste,
Si rrudhat e fotografive në kornizë
Zgjohej një ditë e bezdisshme .

NËPËR NETËT STERRË

Nëpër netët sterrë ikin njerëzit
Dhe qyqet,
Fshehurazi vijnë zërat e të huajve.
Dhe lehjet
Nuk pushojnë me shekuj.

Zvarriten rrugëve mallkimet e hienave
Hungërojnë netët,
Nën peshën e një britme të llahtarshme
Si ushejzat e zeza,
Rrëshqasin disa hije
Edhe më të zeza se vet hijet.

Ikonat bredhin rrugëve
Bredhin të trishtuara,
Si netët e çmendura ballkanike.

Nëpër mure të ngufatur nga lagështia
Si në ndonjë kor antik,
Dëgjohen piskamat
Nuk pushojnë ,
As ulërimat e kërpudhave.

Nëpër netët sterrë
Si fantazmat zgjohen qytetet,
Për herë të parë
Njerëzit i çelin sytë,
Dhe fillojnë të ecin
Deri te një dritë e premtuar.

Prishtinë, 03 shtator 2013

Kur dehen perënditë

Cikli i dytë

POR GJITHSESI

Nuk di athua ishte koha e përshtatshme
Ose binte një tjetër shi i egër.
Atë çast,
Mjegullat me do riga të vetmuara.
Vajtonin fatin e reve,
Por gjithsesi
Acari i lagte flokët e thinjura të erës.

Ne ishim të vetmuar,
Ndoshta vetmonim në shpirtin tonë
Si rrapet të shkrepat e zanave,
Por, gjithsesi
Një vetmi e habitshme
I krihte flokët e shirave të mykura.

Frynte një erë e verbët me shi
Herë i përngjante shtrezës,
E herë bëhej një shakullinë e tmerrshme
Nëpër xhepat e arkivoleve .
Varrtarët kumarxhi
Mblidhnin një lloj tagri nga të vdekurit,
Por gjithsesi
Ne ishim ata që u përngjanim varreve.

BËHESHIM BRETKOSA TË VERDHA

Sa shumë i përngjanim
Ndryshimeve atmosferike,
Orë e çast ndryshonte pamja e jonë
Nga ai i dyzetkëmbëshit.

Kur vinin shirat
Ne iknim prej lëkurës tokës,
Fshiheshim
Mes ëndrrave të fëmijërisë.
Ose... pësonim një metamorfozë
Bëheshim bretkosa të verdha.

Por dosido filluam nga pak
T'i përngjajmë,
Mollës së këputur nga një degë
E harruar,
Ose shtireshim kinse ajo mollë e egër
Ka filluar të na përngjaj neve.

Më kujtohet kur ishim adoleshent
Kishim një dëshirë të flaktë,
T'i përngjajmë vetëm një ditë
Fëmijërisë së fqinjëve të kamur.

Por dëshirat
Përherë ishin vetëm dëshira,
Kurse ne akoma mbetëm
Mes disa premtimeve shterpe .
Dhe dëshirave boshe,
Që asnjëherë nuk u plotësuan.

TË MOS QAJ EDHE AJO COPË DRURI

Nëpër brinjët e thyera të natës
Kthehen mërgimtarët
E vonshëm,
Si trenat e çmendur të fëmijërisë
Dalin zogjtë në pritje.

Dalin edhe burrat në log
Me nga një shami përmallimi,
Te parmakët e dritareve
Çelin trishtim lotët e etërve.
Nga mesi i stinës
Nënat presin,
Me padurim presin kthimin e zogjve.

Më kujtohet kur shkuat
O fare mirë më kujtohen,
Çastet e ndarjes
Nëna e mirë,
Përqafonte një pikë loti
Të mos ngrihej dita në syrin e saj.

Kurse babai i komshiut tim
Me madhështinë e një plaku,
Ja shtrëngonte dorezën bastunit.
Ja shtrëngonte,
Të mos qaj edhe ajo copë druri
Të mos dënesi si guri i lagjes,
Ku kanë pritur pleqtë e fshatit
Kthimin e djemve nga kurbeti.

VERA E VJETËR

Sonte era me gishtat e saja të holla
Po i prek të gjitha yjet.
Po edhe i preku,
Flokët e shthurura të mjegullave.

Te një kafene e qytetit
Me një gotë në dorë,
Shoh mikun tim të fëmijërisë.
Në kacafytje me të kaluarën
Vera e vjetër,
Dehet tok me devenë e egër të cirkut.

Nata dhe era
Si kalorësit e apokalipsit,
I shtrëngojnë dizgjinët
Nga shpirti antik i kalasë,
fluturojnë për herë të parë
Pëllumbat prej argjile.

Sonte si furtuna shkojnë
Dhe kthehen vërdallë,
Mendimet e mira dhe ato të liga.
Diku te mollët e shkundura
Sërish hingëllojnë ,
kuajt e lodhur të luftës.

KUR DEHEN PERËNDITË

Për çdo mbrëmje
Dikur kah mbarimi një tregimi,
Kur fundoset dita e trishtuar
Dalin burrat t'i përshëndesin kryqet.

Mes gjetheve të këputura
Miku im i vjetër,
Pranë një faltoreje
Reciton "Poemën e Mjerimit".

Për çudi vetëm atëherë
Kur dehen perënditë,
I kujtohen "Tullumbat e Lulit"
Dhe qanë deri vonë në mbrëmje.

Si një fëmijë i braktisur
Qanë edhe gjysmëhëna,
Tok me kryqin
E harruar diku në kujtesë.

Për çdo mbrëmje
Enden këndej pari hijet endacake,
Arkivolet e boshatisura
Kanë filluar të ikin.

Po ashtu kanë zënë ti ikin
Në disa vende të panjohura,
Edhe kufomat
Askush më askurrë nuk i beson
Vdekjes së kryqit
Dhe të gjysmëhënës.

NËN DRITAREN TONË

Ka një kohë të gjatë
Po më mundon një problem,
Nuk di, por atë natë
Nuk ishte diçka në rregull me reshjet.
Përtej kujtesës së gjelbërimit
Kishin ikur shirat.

Nën dritaren tonë
Kalonin disa trena të mërzitshëm,
Kurse akoma nuk e kam të qartë
Athua isha me ty!?
Ose në shpirtin tim
Kishte lëshuar rrënjë vetmia.

Ndoshta që të dy ne mungonim
Në zbrazëtirën e asaj dhome,
Ose vetëm dhoma mungonte
E cila kishte një kokëçarje të madhe.
Me lagështin e mureve,
Dhe rrinte varur për një gozhdë
Që kishte zënë të thyhej nga ndryshku.

Mbase ishte një mungesë e paarsyeshme
Nga sytë e përlotur të ikonës,
Si një lumë i çmendur pikonin lotët
Çurgonte vetmia ,
Në shpirtin e dërmuar të çatisë.

Prishtinë, 04 gusht 2013

EDHE NJË NATË SI KJO

Nëpër dendësinë e shiut
Llamburitin varkat e verbëta,
Një natë pa yje
Ngarend hapësirave të pamat.

Asnjeri nuk paska mbetur nëpër rrugë
Vetëm mjaullimat e maceve të egra,
E prishin qetësinë monotone
të sterrës së parfymosur ,
Nëpër shtëpitë me drita të kuqe
Dënesin drurët e çative.

Edhe një natë si kjo,
Dhe e arrijmë fundin pa fund.
Të një fillimi të mbrapshtë
Nuk dimë se ku ishim dje,
As që kemi kohë të mendojmë
Se ku jemi sot.

Kjo kohë elektronike qe sa kohë
Si ushejzat e verdha,
Ka filluar të depërtoj nëpër gjakun tim
Marrëzisht të kalëroj,
Damarëve të sëmurë të mendjes
Kjo kohë e një nate të paharruar.

SONTE KAM NJË TJETËR PUNË

Sonte kam një tjetër rrugë
Dhe një tjetër punë,
Do të eci shtigjeve
Kah largohen,
Ose kah zbresin yjet e vetmuara.

Ti më pritë te portat e hapura
Nëse mbyllesh në guaskën e erës,
Të lutem ,
Lëre çelësin e fjalëve
Nën gjuhën e hënës se për ndryshe
Si mund të hyj në gjumin tënd!

Ti flejë me një sy
Kur të trokas te qepallat e mbyllura,
Ose në portat e mjegullave
Mos të më dëgjoj askush,
S'dua t'i pengoj askujt
Në këto orë të vona.

Sonte kam një tjetër punë
Nga mermerët e kuq të Kosovës,
Dua ta skaliti ëndrrën tënde
Si asaj nuses nga lashtësia,
Që me padurim prite kthimin e Uliksit.

NGA SYRI I NJË PEME TË EGËR

Sonte po bien duart e lisave
Po bien si mjegullat,
Gjethet e një vjeshte të vonuar
Shkasin mureve të mykura të kalasë.
Patërshanat
Shkasin,
Ëndrrat që asnjëherë s'u zgjuan.

Fjetëm edhe nën hijet e rrapeve
Fjetëm,
Kur flinte bari i fishkur.
Nga syri i një peme të egër
Çurgonte si gjak njeriu,
rrëshira e murrme
Pikonte,
Siç pikonin ullukët trishtim .

Sonte mbase është koha e fundit
Për zgjimin e lisave,
Koha është të ecim
Të rendim ,
Nga kjo verbësi e madhe
Më duket se është koha e arkeologëve.

I kujt ishte ai sarkofag nga i cili fluturuan
Disa zogj të çmendur.

QË NUK I PËRNGJAJNË ASKUJT

Kjo natë nuk ka emër
Mbiemri i shiut ka hyrë,
Në fshehtësinë e pantomimës
Dhe nën parmakët e mjegullave blu.
I hulumton
Prejardhjet e zogjve të verbër.

Mbrëmë dolën në shesh
Disa rapsod të rinj,
Që nuk i përngjajnë askujt
Aq më pak rapsodëve të vjetër.
Nuk janë të verbër,
Por këngët e tyre i këndojnë lashtësisë.

Kanë një kushtrim arkaik
Në çdo iso,
Dëgjohen se si rendin kalorësit e nëntokës.
Që kalërojnë
Pa shalë e dizgjin,
Kuajt e tyre të luftës u përngjan
Mu atyre kuajve,
Që u përkasin vetëm perëndive.

DISA KTHEHEN NË ATDHE

Mbi degët lakuriqe të natës
Pa zë dënesin,
Zogjtë e verbër të një stine.

Një hënë e zhveshur deri në asht
Kundron në heshtje,
Peizazhin e pasosur të yjeve që këputen.

Mjaullimat e përziera
Me zërat e zogjve të verbër dëgjohen,
Dëgjohen diku larg
Matanë maleve.

Edhe lehjet e meteorëve
Kanë një zë të përmallshëm,
Doruntinat
Sonte nuk kthehen në shtëpi.

Do presim edhe një kohë të gjatë
Ashtu siç pritëm çdoherë,
Dyndjet e zogjve.

Po ashtu edhe ato të njerëzve
Nuk dinë të ndalen,
Disa kthehen në atdhe
E disa të tjerë largohen!..
Si pa kokë,
Ikin nëpër një turbullirë
Prej mjegulle.

FILLIMI I ETJES

Mbrëmë morra pak dritë prej hënës
Kurse prej syve të diellit,
Krijova një tjetër imazh
Dhe duke u zvarritur zbrita,
Në fundin e një bote
Që asnjëherë nuk ka ekzistuar.

I pashë disa pamje të çoroditura
Ishin pak më ndryshe,
Se sa këto që shtrihen
Mbi degët lakuriqe të kujtimeve .

Këtu dënesin me javë të tëra
shpirtrat e zogjve,
Dënesin
Si pikëllimet e yjeve endacak.

Gjatë tërë natës bredha rrugëve
Me drurët e verbër,
Nuk pata kohë
As për një gotë vere të vjetër.

Fillimi i etjes
Ishte diku afër meje,
Sa që përfundova
Në mbarim të zjarrmisë së stinës.

Një natë e gjatë
Më e gjatë se sa një tërkuzë samari,
Shtrihej udhëve...

... Duke përtypur dhembjet e ditës
Nëpër molin e kujtimeve,
Si derrat e egër
Vraponin kaprojtë e tredhur
Vraponin njerëzit pa fije shprese.

Prishtinë, o5 shtator 2013

ATJE KU MBINË NJË DIELL TJETËR

Nuk mund të më kuptoj askush
Se sa më ka marrë malli,
Për qytetin tim të Lidhjes
Për ato kalldrëme ilire,
Që rinë si gur të ngulur.

Në shpirtin e sëmurë të Ballkanit
Enden disa lloje zogjsh.
Kuajt e luftës,
Si në ndonjë ëndërr të keqe
përtypin biografinë e tyre.

Sa herë që netët aziatike
Këndojnë nëpër rrugicat e ngushta,
Si thupra e çeliktë dridhet sterra
Tmerrësisht dridhet ura e gurit.
Kur dënesin harqet,
Në shpirtra të mykura të myshqeve.

Një natë në qytetin tim
Pranë lisit të vjetër në Marash,
S'mund ta krahasoj me asgjë
As me njëmijë net jete.
...Të këtij metropoli,
Ku si dallgë deti zgjohen përmallimet.

2.

Asnjë mbrëmje nuk i përngjan
Njerëzve të qytetit tim.
Do largohem,
Fshehurazi do zhdukem sonte
Me vetminë e hënës.

Do kapërcej përmbi malet e Sharrit
Atje ku mbin një diell tjetër,
Krejtësisht i ri.
... Dhe shumë më ndryshe
Se sa ky diell i huaj këtu,
Që ma kafshon trurin
Si një bishë e egër.

MBASE ISHIM TË BINDUR

Asnjëherë nuk të thash lamtumirë
Qyteti im i lashtë,
Asnjëherë...!

Edhe atë ditë kur u ndamë
Ty s'të ndryshoi qerpiku,
Por, edhe unë s'u ligështova
Mbase ishim të bindur,
Se mes nesh
Nuk ekziston fjala lamtumirë.

Edhe sot jemi po aq të ngjizur
Sa që s'mund të jetojmë,
Pa njërin e pa tjetrin
Me një dallim të shumëfishtë.

Ti jeton
Me një shpirt të madh,
Dhe krenar
Kurse unë,...
I ngarkuar me lot përmallimi!

Askurrë nuk i thamë lamtumirë
Njëri – tjetrit,
Po sa me përmallim jetojmë
Ti nën çatinë tënde shekullore!?
Kurse unë,
Nën çatitë e huaja si një maçorr
Me peshën,
E një zjarri përvëlues
Që asnjëherë nuk shuhet.

MBI NJË MERMER TË KUQ

Ne atë ditë kishim mjaftë kohë
Aq sa për t'ua thënë,
Edhe të tjerëve.
Por ti ishe sa afër
Po aq larg meje.

Sytë e t'ua preknin horizontin
Kurse dora e djathtë,
Shtrihej mes mermerëve gri.
Dhe i lexoje
Epitafet e vjetra nëpër varre.
Lexoje
Dhe dënesje si bari i fishkur.

Në pamundësi të veproj
Pak më ndryshe,
Heshta si guri i zi.

Më pastaj një kohë të gjatë
Ndoshta,
Deri në pambarim
Bisedova me një rrasë.
Dhe të nesërmen,
Mbi një mermer të kuq
Skalita portretin e erës.

MOS GUXO TË NDALESH

Ec kryelartë mikun im
Mos guxo të ndalesh,
Nëse rastësisht
Të dalin përpara lukunitë,
Ti sërish ec,ec....
E mos u ndal asnjëherë!

Po që se të rëndohen hapat
Ti atëherë fillo të vraposh,
Ndaljet
Nuk janë të shëndetshme
Kur këndon acari.

Të thash ec miku im
Nëse ta ndajnë rrugën lukunitë,
Në dy gjysma
Ti kurrë nuk guxon të ndalesh.

Sepse njeriu ka lindur
Për të gjuajtur një gur të madh,
Dhe një hap gjigand
Shumë hapa përpara vetes.

TA GËZOJ LIRINË TËNDE

Nuk di a jam,
Ose s'jam i dashuruar,
Por sonte dua t'i përqafoj malet
T'i përqafoj ashtu,
Siç e përqafoja dikur të dashurën grua.

Të frymoj si zogjtë e kaltërsive
Të fluturoj pa pasaportë hapësirave,
Të pamat.
Ta gëzoj lirinë tënde
Moj tokë e përvuajtur dardane.

Sonte dua të jem vetëm
Vetëm përhitja e ime ka të drejtë,
Të bredhi si një Perëndi Ilire
Nëpër shpirtin
E sinorëve të shkulur të atdheut.
Askush ama po ju them
Askush nuk më duhet sonte.

As ti e dashura grua
O ju lutem!
Ju përgjëroj me mallin e mëmëdheut
Më leni vetëm,
Sonte dua t'i përqafoj këto male
Si dikur që e përqafoja të dashurën time.

DOLI EDHE NATA

Çdo gjë është e zbrazët në këtë çast
Më lërë ta pi gllënjkën e parë,
Të helmit të këtij trishtimi.

Sonte kjo natë homerike
Po qanë si një foshnje,
Te një dunë e vdekur
Si nga toka mëmë,
Mbinë do hije të zeza.

Si drurët po më digjet shpirti
Në këtë zbrazëtirë të paanë,
Sonte me do pisha po digjen
Edhe kujtimet e një nate.
Më lërë ta pi
Trishtimin e këtij helmi!

Çdo gjë e zbrazët
Në këtë zbrazëtirë të pashpirt,
Duart e erës në një vakum
Pa ajër notojnë,
Si zogjtë e verbër
Notojnë nëpër detin e trishtimeve.

2.

Sonte kjo gllënjkë pelini
Doli nga fundi i gotës së mbushur,
Doli edhe nata
Dhe iku diku...!

Kudo zbrazëtirë e errët
Në secilin hap humnerë,
Përpos,
Që nga fundi i gotës
Po zgjohet një trishtim i madh
Si trishtimi i njeriut.

Prishtinë, 05 shtator 2013

KURSE KALLDRËMET ILIRE

Nëse trokas në portat e kujtesës
Dhe nëse nuk ka njeri të gjallë,
Për t'i hapur kujtimet
Sërish do i ftojmë .
Arkeologët e imagjinuar
Që t'i rihapin varret.

Më së miri,
Këtë gjuhë të pantomimës
E njohin arkivolet,
Dhe varret e hapura
Kush e di se për të satën herë.

Kur e patëm historinë njerkë
Erdhën të huajt në trojet tona,
Dhe shkruan
Një tjetër histori të çoroditur.

Netët ishin një tjetër lloj tregimi
Nga majat e thikave ,
Pikonte gjaku i zi
Pikonte një lloj rrëshire,
Kur në qenien e barit të fishkur
Qante agullima.

Edhe mëngjeset nuk ndryshonin
Mbinin nga trishtimet e netëve,
Mbinin si kërpudhat e helmuara
Kurse kalldrëmet ilire,
Gurtë e skalitur të një epoke
Nuk e qanin kokën për asnjë tregim.

ATYRE VALLEVE ARKAIKE

Nëse mbesim pa ëndrra
Dhe nëse në gjumin tonë,
Mbinë manaferrat
Si mund ta mësojmë përmendësh
Artin e pantomimës.

Sa herë që biseduam me gurtë e lumenjve
Era na i gëlltite fjalët,
Asnjëherë nuk na shkoi për dore
T'i mësojmë pëllumbat prej argjile
Se si duhet të fluturojnë.

Kur dolën dasmorët te bredhat e bardha
Daullet veç kishin pushuar,
Një valle që i përngjante
Atyre valleve arkaike.
Lisat nuk mund t'i ndalnin lotët e erës!

Qante me ngashërim një njeri
Si zurnaja e evgjitit të moshuar,
Qante dhëndri i pafat
Qante edhe nusja,
Për fishekun
E fshehur në pajë.

NJË RRAP RRËNJËSHKULUR

Si trishtimet e shpirtrave
Po zgjohen pasionet,
Ky mirazh prej hëne
Me lotët e yjeve ,
I lanë duart e plagosura të erës.

Zbresin tej e tej maleve
Sutat e vetmuara,
Zbresin si perëndeshat ilire
Në tokën e bekuar të një ëndrre.

Në sytë e meteorëve
Mbinë lumenjtë e verdhë,
Zogjtë e fëmijërisë
Sërish dalin nga lëvozhga.

Një rrap rrënjëshkulur
Vetmon me gjethet e fishkura,
Në heshtjen krenare të ditës
Vetmojnë edhe baladat.

Megjithatë shpirtrat e mallkimeve
Te një përrallë e shembur,
Paskan filluar edhe kësaj herë
Të këndojnë zogjtë e shpresës.

MBI FLOKËT GRI TË MJEGULLAVE

Mbi një mermer të kuq Kosove
Sonte skalita fytyrën e heshtjes,
Ishte një natë e zverdhur
Nëpër qytetin e të vdekurve,
Parakalojnë si do hije të zeza
Perëndit prej guri.

Rendin edhe zogjtë e verbër
Rendin pandërprerë burra e gra,
Me nga një copë qefini
Mbështjellë trupit,
Rendin stinët veshur me gjethe
Parakalojnë si kufomat
Ylberet flokëthinjur.

Të moshuarit paskan mbetur
Me vetminë e tyre të trishtuar,
Mbi flokët gri të mjegullave
Reshin stinët e dërmuara.
Gjethet s’pushojnë së lehuri
Si gurtë e zi të qiellit katran,
Reshin pikëllimet e një nate.

Ishte një kohë kryeneçe

Cikli i tretë

TE NJË FUND I IMAGJINUAR

Përmes dendësisë së mjegullave
Zgjohen zërat,
Si mallkimet e hijeve
Dalin nga nëntoka
Kalorësit e apokalipsit.

Te një fund i imagjinuar
Vajtojnë dunat e trishtuar,
Pas shpinës së maleve
Dëgjohen piskamat e drurëve.

Nëpër shtigjet e pikëllimeve
Nga larvat e ditës mbinë fluturat,
Mbinë edhe njerëzit
Te varret e evgjitëve,
Këndojnë pasionet e vjetra.

Nga jugu frynë
Një stuhi prej dëbore,
Në sytë e një ikone
herë kyçen e herë shkyçen qirinjtë.

2.

Nuk paska mbetur askush
Këndej pari,
Vetëm frymëmarrja e urës
Dëgjohet me një gërhitje të thellë.

Dëgjohen
Edhe mallkimet e zërave...
Që burojnë
Nga shpirti i moshuar
I Lumëbardhit krenar.

U PLAKËM MOJ NUSE

U plakëm!
U plakëm moj nuse...
Askush si unë në këto çaste fatale
Nuk i përngjan,
Zgërbonjës plakë
Të një rrapi në malin e jetës.

Kur ishim të rinj
U përngjanim fluturave endacake
Fluturave moj nuse...!?

Askush si unë nuk i përngjan
Këtij dimri që bren hekurin,
Kur ndryshken stinët
Bie shi moj nuse
E ndryshken kujtimet.

U plakëm moj nuse
U plakëm !?
Në zgërbonjën e një druri të vjetër
Ku asnjëherë më

Nuk vijnë të trokasin zogjtë.

POR GJITHËSESI

Nëse jo sot ne një ditë
Do të ecim drejtë një qëllimi
Pa pasione të sëmura.

Do të kalojmë si një njeri i verbët
Nëpër dhomat e ngrira,
Kur të mbërrimë tejpërtejmes
Nëpër zgërbonja lisash
Do i fshehim ëndrrat.

Do të ecim një kohë të gjatë
Do ecim.....
Deri sa i përngjajmë perëndive.
Nëse jo në këtë botë
Atëherë,
Duhet të provojmë në botën tjetër.

Por, domosdo
Duhet të provojmë në ecjen tonë,
Se si ta sajojmë

Fytyrën e imagjinatës së mykur.

Kur dalim nga lëkura e jonë
Diku në fund të udhëtimit,
Na pret një arkivol
Ose ne e presim arkivolin e verdhë.
Por, gjithsesi
Te një fund na pret

Një dështim i përjetshëm.

BRENDA NË DHOMË

Bënte ftohtë
Ajo bisedonte me erën e ngrirë,
Kurse gjatë tërë natës
S'ndaleshin mjaullimat
S'ndalej as ulërima e stuhisë.

Një dimër i acartë si ky
Ka kohë që s'ka trokitur,
Në portat tona
Thonë se është e zezë.
Kjo stinë
Kudo hungëron sterra e paparë.

Përtej mureve po qanë një dru
Brenda në dhomë,
Si stalagmit ngrihet loti
Nga shpirti i çatisë,

Si nata e trishtuar pikon bloza.

PA SHKOPIN E PLEQËRISË

Më kuptoni djemtë e mi
Jam plakur shumë,
Pak si shumë
Po më mundon diabeti.
Kjo moshë e thinjur
Në çdo hap,
Po ngre nga një kurth të tmerrshëm.

Kanë zënë të më merren këmbët
Asnjë hap s'mund të bëj,
Pa shkopin e pleqërisë
I cili po kollitet si një kalë i vjetër.
Po kollitet jashtë çdo mase
Ky shkop prej shkoze.

Me siguri nuk ju kam treguar
Nuk desha të ju ngarkoj,
Me problemet e mija
Mua për çdo ditë po më ikën miqtë.
Vetëm bastunët e tyre

Mrizojnë nën çatitë e ngrira.

2.

Ka kohë që s'keni qenë në shtëpi
Kanë filluar të kërrusen,
Edhe muret prej lagështisë
Po kërrusen si shpirtrat
Edhe trarët.

As qeni i juaj më nuk leh
Në stelën e vjetër,
Ku kanë zënë vend merimangat.
Aq shumë ka lehur gjer më tani
Sa që iu dëmtuan kordhat e zërit.

ISHTE NJË KOHË KRYENEÇE

Ti mos hezito,
Ledhatoje vazon e trishtuar
Ku s’rritet asnjë lule.

Nëse nuk ia kalon vetvetes
Ti do të mbetesh pa emër,
Ashtu siç ka mbetur
Pa mbiemër lulja e pikëllimit.

Dikur moti,
Kur qanin gurtë pa zë.
Vajet ishin tejet të trishtuara
U përngjanin,
Vajtimeve të mjegullave.

Qanin si cirqet e vetmuara
Në brigjet e Jonit idhnak,
Kur përmbyteshin anijet
E peshkatarëve të dehur.

Ishte një kohë kryeneçe
Koha në të cilën njerëzit,
Për një fjalë goje
Sa ora shndërroheshin

Në harresë.

Koha kur këndonin patërshanat
E ndryshkura,
Në lotët e topitura të mëngjeseve

Qanin qyqet.

KY QYTET

Kam kuptuar
Dikur vonë kuptova se nga hidhërimi,
Mbinë një natë e trishtuar
Mbinë si lulja,
Që i përngjan lotit të pritjes.

Shitësja e trëndafilave në qytetin tim,
Shet një lloj dashurie që pikon nga lulet.
Të cilën vetëm të moshuarit
Mund ta blejnë,
Në ndërrim me dhëmbët artificial.

Ky qytet i cili mbiu
Nga shpirti i një fantazme,
Me shekuj pinte ujë
Kurse te rrënjët e një lisi.
E shuante etjen e kaktusit,

Në gungën e devesë së shkretëtirës.

TË FUNDOSEM SI TITANIKU

Sonte i shpenzove të gjitha fjalët
Skalita në mermer,
Pamjen e brishtë të një Afërdite
As hëna binjake ,
Nuk ndërroi mendimin
Për bukurin e saj prej uji.

Edhe nata e sotme,
Nuk i përngjante netëve të tjera.
Flokët e saja gri
Si ujëvarë e trentë lëshoheshin,
Teposhtë derdhjes së Lumëbardhit
Ku një hënë e buzëqeshur
I ankoronte varkat e fundosura.

Nëse edhe njëherë më harxhohen
Fjalët si sonte,
Kurse ti vjen me zgërdheshjet
E tua të njohura për të gjithë.
Të lutem më lërë rehat,
Që të fundosem si Titaniku
Në shpirtin e vetmuar
Të kësaj nate qorre .

Prishtinë, 07 shtator 2013

KUR ARRITËM

Kur arritëm me pak vonesë
Ende shkulmonte flaka e verdhë,
Deri te mjegullat
Shkonte një vijë e hollë tymi.

Ishte e vonshme ardhja e jonë
Flakët lëpinin muret e lagështa të shpirtit,
Edhe nata kishte një zjarrmi të madhe
Digjej si anijet Kartagjenase.

Kur arritëm me pak vonesë
Ti veç kisha hyrë në gjumin e amshimit,
Flinte edhe hinorja përballë një murane

Kur arritëm ishin lëshuar perdet antike.

KANË FILLUAR DASMAT

Filluan të vijnë mërgimtarët
Po vijnë hije rënd,
Si mirazhet e gjyshërve tanë
Sërish po kthehen,
Te ty atdheu im.

Kanë filluar edhe dasmat
Nuk dinë të pushojnë!
Daullet ilire,
Netët janë shndërruar
Në dritë të bardhë
Kurse ditët,
Në ngjyra inkandeshente.

Kanë filluar të vërshojnë ujërat
Vashat kalojnë rrugëve,
Me zambak në flokë
Ehu, paskan filluar dasmat
Do na shkojnë
Doruntinat në Perëndim!

NJË MERIMANGË E ZEZË

Kur përfunduan ritualet
Dielli veç kishte ikur,
Hëna e varur të një çengel i akullt
I numëronte dështimet e përsosura
Të ecjeve tona.

Numëronte dhe i njehsonte
Të gjitha pikat e ikjeve,
Me disa numra të panjohur
Fundi i llogarisë akoma nuk dihej
Varrmihësit,
Si të çmendur rrëmihnin tokën.

Erdhën ca njerëz të panjohur
Dhe na sollën disa lloje lutjesh,
Te një kornizë
Ku s'pushonin vajet e ikonave.
Një merimangë e zezë
Si e çmendur,
Shthurte kurthin e kurdisur.

SYRI PISHË I ERËS

Kur ecëm nëpër pranverat
E një stine të egër,
Disi ishim më të mobilizuar
Syri pishë i erës,
Asnjëherë nuk lotonte.

I kapërcyem të gjitha shtigjet
E etjeve,
Kur mbërrimë për herë të parë.
Ta puthim kaktusin e egër
Hapat na mbetën diku pas shpine,
Asnjë fanar
Nuk na i tregoi udhët.

Sërish ia filluam ecjes nga e para
Në vazot prej deltine,
I mbollëm për herë të dytë
Të gjitha llojet e luleve.
I mbollëm ,
Por mjerisht si çdoherë mbetëm
Pa i shijuar aromat e stinëve.

I PËRNGJANTE NUSES ME BARRË

Unë një ditë do të nisem
Do të shkoj diku larg,
Nuk po ju lus të më pritni
Sepse atje ku shkoj,
Rruga është e gjatë dhe e pakthyeshme.

E pakthyeshme,
Si fjalët e koprracit.
Nëse rastësisht ndonjëherë
Takohemi përtej asaj dune.
Dijeni fare mirë,
Se nuk më keni përcjellë ju mua
Por, unë ju përcolla
Gjatë gjithë udhëtimit tim.

Ishte një kohë pak më ndryshe
Se dita e sotme,
E ngarkuar me shi
I përngjante nuses me barrë.

Asnjëherë,
Nuk ndaleshin vetëtimat
S'ndaleshin as lotët e një fëmije,
Që pritet me padurim
Lindjen e tij në një tjetër kohë.

NGA LARTËSITË E PAEPURA

Kush e zhveshi qiellin
Kur sonte vajtonin meteorët,
Në këtë pamje surrealiste
Si derrat e egër galopojnë yjet.

Pandërprerë lehin netët e tërbuara
Në lakuriqësin e hapësirës së paanë,
Lehin jashtëtokësorët
Askush s'pushon së lehuri sonte.

Po, nuk flenë as meduzat e verdha
Drurët e njomë nuk kanë gjumë,
Në lotin e këtij teatri antik
Derdhen disa lloje dallgësh të çmendura.

Nëpër lartësitë e paepura
Rendin disa lloje kameleonësh,
Këto pamje të cilëve nuk ua di emrin
Po shndërrohet në do shtatore prej xhami.

Prishtinë, 08 shtator 2013

KY MAL SONTE

I mbylla të gjitha dyert
Ose dyert e hekurta,
Më mbyllën përbrenda kujtesës.

Asnjë zë njeriu
S'dëgjohet matanë ëndrrës,
Përfundimisht paskan heshtur
Edhe gjinkallat e sëmura të përtypjes.

Ç'farë po ngjan në këto çaste
Me turbullirat e ujërave,
Po frikohem pa masë
Më ndjek një frikë.
Se do të përmbyten detet
Në shpirtin e shthurur të poemës
Një lis paska mbetur tejet i vetmuar.

Asnjeri sonte nuk troket
Në fshehtësinë e malit të paprerë,
Drurët lozin si përherë
Një valle të lashtë mortore
Lozin edhe gjethet.
Me duart e vetmuara të ajrit
Ky mal ëndërrimtarë,
Sa shumë po i përngjan sonte
Një valleje të lashtë pagane.

KEMI HARRUAR SE JEMI NJERËZ

Kemi harruar se si përqafohen njerëzit
Mbase edhe kanë vdekur miqësitë,
Këtu në këtë metropol puthen.
Vetëm hijet
Puthen,
Si majmunët nëpër lis.

Ne për çdo ditë nga pak
Po i harrojmë përshëndetjet,
E lashta ilire.
Mes trotuareve blu,
Është tretur tungjatjeta e jonë e lashtë.

Autobusët rendin me orar të përpiktë
Rendin si të çmendur,
Nëpër asfaltin e djersitur
Ku në çdo hap shumohen,
Fytyrat e zverdhura të njerëzve.

Më duket se kemi harruar
Se si trokasin miqtë,
Në portat e hekurta.
As si duket mirëseardhja e jonë
Për ndonjë mysafir të paftuar.

Çdo vitrinë këtu na kafshon
Si gjarpri nga pak në shpirt,
Kemi harruar se jemi njerëz
Dhe si priten miqtë,
Kur trokasin në dyert tona
Që s’u mbyllën asnjëherë .

PO BIEN EDHE GJETHET E FUNDIT

Ishe engjëllushe e paprekshme
Një bukuri e lashtë antike skalitej,
Si një vegim i kapshëm
Në hapësirën e paanë,
Të anatomisë së trupit tënd.

Sa herë që hyre në kornizën e praruar
Kishim mall të të shohim ,
Me atë buzëqeshje të sedeftë
Kurse sot për çdo ditë nga pak.
Si gjethet e zverdhura të një dege
Po bie bukuria e jote,
Po bie mbi stinët e lodhura.

Kjo moshë e shtyrë sivjet
Si një vagon i vjetër trenash,
Po kalon nëpër binarët e jetës
Po i shkelë shinat e ndryshkura,
Në fishkëllimën fundit
Po i përngjan njeriut.

Po bien edhe gjethet e fundit
Të kësaj vjeshte,
Një ëndërr shket vezullimit të liqenit
Dhe ikën për tu fshehur,
Në sekretin e një arkivoli të mermertë.

SA SHUMË KAM MALL

Dua edhe unë kam dëshirë
Që si paraardhësit e mi pagan,
Të skaliti prej baltës së atdheut
Një perëndi,
I cili me dashuri e përdor gjuhën time.

Ose nga kokrrat
E një cope të pluhurit,
Të gdhendi një njeri prej balte
I cili di,
Dhe mundet me qesh vetëm shqip.

S'do t'i harrojë as kalorësit
E nëntokës,
Përherë i shoh në ëndërr
Patërshanat,
Dhe një njeri që i mbanë në dorë
Dizgjinët e kuajve të luftës
Si trofetë e betejave.

Më besoni kam mall sonte
Sa shumë kam mall,
Të ndjej në thellësinë
E shpirtit tim,
T'i dëgjojë trokëllimat potkonjve.
Kah rendin kalorësit
Prej një ane,
Në anën tjetër të atdheut.

Prishtinë, 09 shtator 2013

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar "Fahri Fazliu", në Kastriot.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.

15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-
Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012

46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12

62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012

78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013

82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88**.”Sytë e gurtë të erës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89**.”Fjetëm njëqind shekuj”**Prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot- 2014
9o**.”Kur dehen perënditë”** , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014

Përmbajtja

Ky njeri prej stralli
Cikli i parë

Nga fisi im bytyq
Po të ishte ndryshe
Prolog
1.
2.
3.
4.
5.
Epilog
Ky njeri prej stralli
Herë fundosem,
Poqe, se të premton koha
I përngjajnë pantomimës.
Më duket se atë natë
Sërish një erë e dalldisur,
Poeti Rreshpja
Kalorësit e kuq të gjakut.
Shkundjet e gurëve
Kur më nuk do të jem,
Varreve ua kthejmë shpinën
Pjatat e drunjta
Nëpër netët sterrë.

Kur dehen perënditë
cikli i dytë

Por gjithsesi,

Bëheshim bretkosa të verdha
Të mos qaj ai copë druri.
Vera e vjetër
Kur dehen perëndit,
Nën dritaren tonë
Edhe një natë si kjo.
Sonte kam një tjetër punë
Nga syri i një peme të egër,
Që nuk i përngjan askujt
Disa kthehen në atdhe,
Fillimi jetës
Atje ku mbinë një diell tjetër.
2.
Mbase ishim të bindur
Mbi një mermer të kuq,
Mos guxo të dalësh
Ta gëzoj lirinë tënde
Doli edhe nata.
2.
Kurse kalldrëmet ilire
Atyre valleve arkaike,
Një rrap rrënjëshkulur
Mbi flokët gri të mjegullave.

Ishte një kohë kryeneçe
cikli i tretë

Te një fund i imagjinuar
2.
U plakëm moj nuse
Por,gjithsesi,

Brenda në dhomë
Pa shkopin e pleqërisë.
2.
Ishte një kohë kryeneçe
Ky qytet,
Të fundosem si titaniku.
Kur arritëm,
Kanë filluar dasmat
Një merimangë e zezë
Syri pishë i erës,
I përngjante nuses me barrë.
Nga lartësitë e paepura
Ky mal sonte,
Kemi harruar se jemi njerëz
Po bien edhe gjethet e fundit
Sa shumë kam mall.